



NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#116

TEKSTET E UNIFIKUARA NË DIASPORË/ Komisioni i përbashkët mbyll fazën e parë



Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën zhvilloi mbledhjen e radhës në Kosovë, në datat 12 – 13 korrik. Kjo mbledhje u mbajt pas përfundimit të fazës së aplikimeve për recensues për vlerësimin e tekstit mësimor për mësimin plotësues në diasporë dhe mërgatë, niveli I. Komisioni shqyrtoi për dy ditë rresht 45 aplikime për përzgjedhjen e recensuesve të nevojshëm për fazën përfundimtare të procesit të vlerësimit të tekstit të përbashkët për Diasporën dhe miratoi listën e recensentëve që do jenë në dispozicion për vlerësimin e tekstit të përbashkët për diasporën, niveli I.

Komisioni i Përbashkët do të vijojë punën me çështjet e tjera të parashikuara në kalendarin e punës, mbylljen e aplikimeve në konkursin e tekstit të përbashkët për tekstin mësimor për mësimin plotësues në diasporë dhe mërgatë, niveli I, në datat 26-28 korrik 2021, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në Prishtinë dhe në datat 29 – 31 korrik, në Qendrën e Botimeve për Diasporën, në Tiranë.



"Apliko online për rinovimin e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimin e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

TAKIMI/ Projekti i mësimin të njëzuar të gjuhës shqipe, ministri Majko bisedë me përfaqësues të Diasporës në SHBA

Ministri i Shtetit për Diasporën, Z.Pandeli Majko realizoi një takim me përfaqësues të Diasporës shqiptare në SHBA. Në këtë takim virtual, Z. Majko foli rreth projektit të mësimin të njëzuar të gjuhës shqipe në Diasporë.

“Për fat të keq nuk na u mundësua nga Komisioni Zgjedhor vota e Diasporës, sepse ky proces do të na kishte sjell edhe më pranë me njëri-tjetrin. Dua të theksoj se kemi realizuar një marrëveshje me Kosovën dhe mendoj se shtatorin tjetër do të mësojmë me libra të njëzuar. Gjithashtu synoj të mundësojmë edhe procesin e shkollës verore. Jemi vonë për disa projekte, por do të vijojmë punën. Diaspora jonë është mjaft e lidhur me familjen, një Diasporë konservativë, dhe kjo i dedikohet edhe faktit pse kemi kaq shumë remitanca...”, u shpreh ministri Majko, e cili përmendi si shembull të mos asimilimit edhe Arbëreshët.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

RISIA/ Aplikacioni “Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare” zëri i biznesit në Diasporë



Për herë të parë të gjithë sipërmarrësit, intelektualët, bizneset dhe agentët potencialë të Diasporës Shqiptare do të kenë mundësi të gjejnë një informacion të plotë dhe koherent mbi gjithçka që ka lidhje me investimet dhe potencialet në Shqipëri. Gjithçka në “pëllëmbë të dorës” në përmjet aplikacionit të sapo publikuar “Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare – ADBC”. Aplikacioni celular ADBC është krijuar për të ofruar informacion të arritshëm për bizneset, sipërmarrësit, anëtarët e Diasporës në Shqipëri, si dhe funksione të ndryshme



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

16 VJET NË UNESCO/ Agjencia Kombëtare e Diasporës i dhuron Gjirokastrës albumin “Kadare”

Në përvjetorin e 16-të të përfshirjes së Gjirokastrës në UNESCO, Drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Sonila Hysi ka zhvilluar sot një vizitë në këtë qytet, ku i ka dhuruar shtëpisë muze, të shkrimtarit albumin “Kadare dhe Gjirokastra”. Album ky i realizuar me rastin e 85 vjetorit të gjenit të letrave shqipe, nga fotografi Roland Tasho me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe ministrit të Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko.



Digjitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

VIZITA/ Drejtoresha e QBD takim me zv/ministren e Diasporës në Kosovë



Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, Mimoza Hysa ndodhet në Prishtinë, ku është takuar me zëvendësministren në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi.

Gjatë takimit u diskutua mbi qasjen e përbashkët ndaj mësimdhënies së gjuhës shqipe në Diasporë, një politikë e nisur me kurrikulën e përbashkët.

Zëvendës ministria Gashi vlerësoi punën e bërë nga Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko dhe Qendra e Botimeve për Diasporën, për zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta në fushën e mësimdhënies së gjuhës shqipe. Vlerësoi gjithashtu punën e komisionit të përbashkët Shqipëri-Kosovë për miratimin e teksteve të përbashkëta.



Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturore dhe ndërveprim. Nisma “Dhuro libra” do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

BASHKËPUNIMI/ Përfaqësues të AKD-së takime në Kosovë

Drejtoresha e Drejtorisë së Diasporës, Znj. Klaudia Hasanllari dhe përfaqësues të sektorit të Diasporës dhe projekteve në Agjencinë Kombëtare të Diasporës zhvilluan një takim me Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë për Punët e Brendshme në Kosovë dhe përfaqësues të Departamentit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar në Kosovë.

Ky takim synon shkëmbimin e përvojave mbi strukturat përgjegjëse për migracionin, Diasporën dhe koordinimin me pushtetin vendor.

Integrimi i Diasporës në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike të vendit është prioritet i Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe shkëmbimi i përvojave të suksesshme është një mundësi për të çuar më tej këtë proces.

